

VENDIM
Nr. 530, datë 7.8.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS PËR UNIVERSITETIN “FAN S. NOLI”, NË
KORÇË, TË PRONËS NR. 549, ME EMËRTIM “SHTËPIA E USHTARAKËVE”, ME
VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “REPUBLIKA”, KORÇË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I
KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës për universitetin “Fan S. Noli”, në Korçë, të pronës nr. 549, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, Korçë për ta përdorur për mjedise pune për krijimin e kushteve për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe për garantimin e një infrastrukture të plotë e funksionale, në plotësim të nevojave të universitetit.

2. Prona nr. 549, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika” Korçë, hiqet nga lista e inventarit të pronave paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Dorëzimi i mjediseve të pronës nr. 549, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, Korçë, të bëhet pas ridislokimit në një destinacion tjetër të strukturave ushtarake të vendosura në këtë godinë dhe pas mbylljes nga Shtëpia Qendrore e Forcave të Armatosura, Tiranë, të veprimtarisë ekonomiko-financiare të këtij filiali, përfshirë heqjen e materialeve dhe të pajisjeve të magazinuara në këtë pronë.

4. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës e universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose ta japin në përdorim te të tretët.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha